



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

# Analiza epidemiologjike mujore (Pasqyra 14 Sh)


ANALIZA EPIDEMIOLOGJIKE MUJORE

NENTOR, 2017

Analiza epidemiologjike e sëmundshmërisë infektive bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh. Pasqyra14-Sh plotësohet në pasqyrën në formatin EXCEL dhe dërgohet me poste elektronike dhe me poste zyrtare në DEKSI, ISHP brenda datës 10 të çdo muaji. Në muajin dhjetor 2017 kanë raportuar 35 rrethe, nuk ka raportuar vetëm rrethi i Hasit.

## ❖ Sëmundjet diarreike

Gjatë muajit nëntor 2017 vëmë re se kemi të njëjtën incidencë të sëmundjeve diarreike për 100.000 banorë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, nëntor 2016, incidenca 233.52. Numri i rasteve sipas çdo nozologjie për muajin nëntor 2017 duke e krahasuar me muajin nëntor 2016 paraqiten në grafikun e mëposhtëm:




Grafiku 1. Numri i rasteve me sëmundje diarreike, nëntor 2016 dhe 2017 të raportuara nga DRSH/DSHP-te.

Rrethet me numrin më të madh të rasteve me Salmonelozë jotifioide për muajin nëntor 2017 janë: Shkodër (13 raste) dhe Berat (1 rast), të gjitha rastet janë të konfirmuara.

Rastet e raportuara me Shigelozë janë: Shkodër (22 raste), Kukës (3 raste) dhe Laç (2 raste) dhe Librazhd, Tirane vetëm me një rast. Nga 29 rastet me Shigelozë, 25 janë raste të konfirmuara.

Numri i toksikoinfeksioneve alimentare në nëntor 2017 ka një rritje në krahasim muajin nëntor 2016 dhe rrethet me problematike janë: Bulqizë (36), Kukës (69) dhe Berat (25). Të gjitha rastet e raportuara me toksikoinfeksione alimentare janë të suspektuara.

Gastroenteritet te paspecificuar janë te shpërndara ne te gjitha qarqet e vendit. Duhet theksuar qe numri i larte i rasteve te raportuara me toksikoinfeksione alimentare dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë ne nivelin e disa rretheve te diagnozës se sakte klinike dhe konfirmimit te saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.




Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve sipas DRSH/DSHP-ve, nëntor 2016 dhe 2017.

#### ❖ Zoonozat


	Nëntor (Raste 2017)	Incidenca (raste/100,000) 2017	Nëntor (Raste 2016)	Incidenca (raste/100.000) 2016
Antraks (Plasje)	1	0.03	2	0.06
Brucelozë	6	0.2	2	0.07
Leptospirozë	3	0.1	5	0.1
Tbc ekstrapulmonar	18	0.6	2	0.07
Rikecie	5	0.1	0	0

Tabela 1. Shpërndarja e zoonozave, numri total i rasteve (Bruceloze, Antraks, Leptospirozë, Tbc ekstrapulmonar, Rikecie në muajin Nëntor 2017 krahasuar me muajin Nëntor 2016.



Grafiku 3. Shpërndarja e zoonozave në numër total rastesh Nëntor, 2017 krahasuar me muajin Nëntor 2016.


## Bruceloza



Grafiku 4. Shpërndarja gjeografike e Brucelozës sipas rretheve në muajin Nëntor 2017 krahasuar me muajin Nëntor 2016.

Ne total janë raportuar 6 raste me Brucelozë në muajin Nëntor 2017 kundrejt 2 raste të raportuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rastet janë raportuar nga rrethet Fier, Pogradec, Gjirokastrë, Lushnjë, Tirana, Skrapar përkatësisht me nga 1 rast.


## Antraksi



Grafiku 5 Shpërndarja e rasteve të Antraksit sipas rretheve në muajin Nëntor 2017 krahasuar me Nëntor 2016.

Ne total është raportuar 1 rast me Antraks ne muajin Nëntor 2017 kundrejt 2 rasteve të raportuar në Nëntor 2016. Rasti i raportuar i përket rrethit Gjirokastër.

## Leptospiroza




Grafiku 6 Shpërndarja gjeografike e Leptospirozës sipas rretheve në muajin Nëntor 2017 krahasuar me muajin Nëntor 2016.

Në total për muajin Nëntor 2017 janë raportuar 3 raste me Leptospirozë kundrejt 5 raste të raportuar në muajin Nëntor 2016. Rastet e raportuara i përkasin rretheve Fier (2 raste) dhe Shkodër (1 rast).

## Tbc ekstrapulmonar

Në total në muajin Nëntor 2017 janë raportuar 18 raste kundrejt 2 rasteve të raportuar në muajin Nëntor 2016. Rastet janë raportuar nga rrethet Lezhe (1 rast), Librazhd (1 rast) dhe Tirana (16 raste).



Grafiku 7 Shpërndarja gjeografike sipas rretheve e Tbc ekstrapulmonar Nëntor 2017 krahasuar me Nëntor 2016.

Rikecie (5 raste) te raportuar në Nëntor 2017 kundrejt 0 raste te raportuar ne Nëntor 2016. Rastet e raportuara i përkasin rrethit Elbasan.

### ❖ Sëmundjet e PKI

#### Fruthi:

Ne muajin nëntor ne pasqyrën 14 sh janë raportuar ne total 7 raste me fruth nga te cilët 5 raste kane rezultuar pozitiv për IgM ndaj Fruthit ne Laboratorin e Virologjisë, ISHP dhe dy negative.

Nga rrethi i Pogradecit janë raportuar 4 raste te moshës pediatrike tre nga te cilët kane rezultuar pozitivë për IgM ndaj Fruthit dhe një rast negativ. Një fëmijë, 3 vjeç është rast i importuar nga Kosova.

Nga rrethi i Beratit është raportuar një rast i moshës 53 vjeç i cili ka rezultuar pozitiv për IgM ndaj Fruthit i cili është i importuar nga Greqia dhe një rast i moshës 17 vjeç qe rezultoi negativ nga Fieri.


Rrethi i Vlorës ka raportuar një rast te moshës, 29 vjeç i cili ka rezultuar pozitiv për IgM ndaj Fruthit. Rasti është i importuar nga Kosova.

#### Varicele:

Rastet me varicele hasen kryesisht ne grupmoshën pediatrike 0-14 vjeç dhe ne kolektiva te mbyllura si institucionet parashkollore çerdhe kopshte dhe shkolla ne forme shpërthimesh te kufizuara.

### ❖ Ethe hemorragjike


Nga survejanca e bazuara ne rast, gjate periudhës Nëntor 2017 krahasuar me te njëjtën periudhe Nëntor 2016, është vene re një trend i qëndrueshëm i rasteve te dyshuara me ethe hemorragjike, përkatësisht nga 2 raste te dyshuara ne muajin Nëntor për secilin vit, te cilat kane rezultuar negative për EHKK dhe vetëm një nga totali i rasteve ka rezultuar pozitiv për EHRSR, gjate muajit Nëntor 2016. Rasti pozitiv për EHRSR, gjate muajit Nëntor 2017, ishte nga Tirana, i gjinisë mashkull, i moshës 25 vjeç.



Grafiku 8. Totali i rasteve te dyshuara me diagnozen Ethe hemorrhagjike gjate periudhes Nentor 2016 dhe 2017

### ❖ Meningoencefalite

Për sa i përket rasteve te dyshuara me diagnozën Meningoencefalite, duke u mbështetur ne te dhënat e Pasqyrës 14 Sh, kemi një trend te qëndrueshëm te hasjes se rasteve te dyshuara meningit bakterial jo meningokoksik gjate periudhës Nëntor 2017 krahasuar me te njëjtën periudhe te vitit 2016.



Grafiku 9. Totali i rasteve te dyshuara me diagnozën meningoencefalite gjate periudhës Nëntor 2016 dhe 2017

Gjithashtu, kemi një trend ne rënie te hasjes se rasteve te dyshuara me encefalit te paspecifikuar gjate periudhës Nëntor 2017 krahasuar me te njëjtën periudhe te vitit 2016. Theksojmë qe gjate muajit Nëntor te viteve 2016 dhe 2017, nuk kemi asnjë rast te raportuar te dyshuar me meningit bakterial meningokoksik, tuberkular dhe viral. Ne lidhje me totalin e meningoencefaliteve gjate periudhës Nëntor 2016 dhe Nëntor 2017, kemi predominim te gjinisë meshkuj ne raport 7:3, me shpërndarje te barabarte ne përqindje si ne grupmoshën pediatrike (50%) dhe grupmoshën e rritur(50%). Theksojmë qe rastet janë raportuar dhe hetuar njëkohësisht nga DSHP, sektori epidemiologjisë, ne rrethet Fier, Tirane, Elbasan, Delvine, Durrës dhe Devoll.

### ❖ Sifilizi

Gjatë muajit nëntor 2017 ka pasur 2 raste Sifiliz primar të raportuar nga Elbasani dhe Fieri. Rastet i përkasin grupmohave 15-19 vjeç dhe mbi 65 vjeç.

Për këtë muaj kemi vetëm një rast me Gonorre që i përket grupmohës mbi 65 vjeç dhe është raportuar nga rrethi i Fierit.

### ❖ Hepatitet virale


Ne raportimin mujor te semundshmerise infektive gjate muajit nëntor 2017 janë raportuar ne total 24 raste me hepatite virale akute nga te cilat 9 raste janë Hepatite virale te paspecifikuar, 1 rast me Hepatit viral A, 12 raste me Hepatit viral akut B dhe 2 raste me Hepatit virale as A as B. (tabela1)

Periudha kohore	Hepatiti i paspecifikuar	Hepatit viral A	Hepatit viral B	Hepatit viral as A as B
Nentor 2016	6	2	7	1
Nentor 2017	9	1	12	2

Tabela 2

Siç shihet edhe nga grafiku 1, ne krahasim me te njëjtin muaj një vit me pare, numri rasteve te raportuar me hepatite virale akute ka pësuar rritje këtë vit përveç hepatitit viral A.

Duhet theksuar se rastet me Hepatit viral te paspecifikuar gjate muajit nëntor te vitit 2017 i përkasin grupmohës 4-9 vjeç (2 raste), grupmohës 10-14vjeç (2 raste), grupmohës 15-19 vjeç 3 raste dhe 2 raste ne grupmohën 40-44 vjeç. Rasti me Hepatit viral A i përket grupmohës 15-19 vjeç. Persa i përket HBV 1 rast i përket grupmohës 14-19 vjeç dhe rastet e tjera janë te shpërndara ne gjithë grupmoshat e tjera . Ndërsa për 2 rastet me hepatit as A as B grupmosha e prekur është ajo adulte 30-34 dhe mbi 65 vjeç. Nga hetimi epidemiologjik i kryer për këto raste rezultoi se janë raste sporadike pa lidhje epidemiologjike mes tyre.



Grafiku 10. Numri i rasteve me hepatite virale, nëntor 2016 dhe 2017.

Vazhdimi i raportimit te rasteve me hepatit viral te paspecifikuar ndodh për shkak te kapaciteteve te pamjaftueshme laboratorike për diagnostikimin e tyre ne laboratorët mikrobiologjike te DSHP ne rrethet e vendit. Ne lidhje me shpërndarjen sipas rretheve, gjate këtij muaji Dibra ka raportuar 5 rastet me Hepatite virale te paspecifikuar ndërsa rasti me HAV është nga Tirana. Këtë muaj Shkodra ka raportuar 5 raste me HBV dhe 1 me as A as B ne krahasim me vitin e kaluar qe ka patur vetëm 3 raste me HBV.

### ❖ Tuberkulozi pulmonar

Gjate periudhës Nëntor 2017, krahasuar me muajin Nëntor 2016, vihet re një rritje e lehtë e numrit të rasteve të raportuara me tuberkuloz pulmonar përkatësisht nga 26 raste ne Nëntor 2016 në 29 raste në muajin Nëntor të vitit 2017. Duhet theksuar se burimi i te dhënave të muajit Nëntor 2017 është Programi Kombëtar i Tuberkulozit pranë SUSM, ndërkohë te dhënat e muajit Nëntor 2016 i përkasin SMBS.

Nëse i referohemi te dhënave te SMBS për muajin Nëntor 2017 shikojmë se kemi nenraportim te rasteve (26 raste) nga 29 rastet qe janë raportuar nga Programi Kombëtar i Tuberkulozit. Persa i përket shpërndarjes sipas rretheve ne te dyja periudhat, Tirana paraqet numrin te madh te rasteve ne te dy periudhat, ne Nëntor 2017 raportohen 14 raste me vendbanim Tirane, ndërsa ne Nëntor 2016 raportohen 13 raste ne Tirane, ndërsa rrethet e tjera raportojnë 1-2 raste.




Figura.11. Paraqitja e totalit te rasteve (numer) me diagnozen Tuberkuloz pulmonar, gjate periudhes Nentor 2017 dhe Nentor 2016.

### ❖ HIV/AIDS

Survejaca e SMBS ne lidhje me diagnozën AIDS paraqet zero raste te raportuara nga rrethet përkatësisht ne muajt Nëntor 2016 dhe Nëntor 2017. Sipas te dhënave te Programit Kombëtar te HIV/AIDS, gjate muajit Nëntor 2016 janë raportuar 12 raste HIV pozitive, ndërsa ne muajin Nëntor 2017 janë diagnostikuar 4 raste HIV pozitive. Shpërndarja sipas gjinisë e rasteve te muajit Nëntor 2016 paraqet 10 raste tek meshkujt dhe 2 raste i përkasin gjinisë femërore; ndërsa ne Nëntor te 2017, 3 raste janë meshkuj dhe 1 rast është femër.

Shpërndarja sipas grupmoshës tregon se grupmosha mbi 45 vjeç zë 50% te rasteve ne muajin Nëntor 2016, vetëm një rast i përket grupmoshës 16-24 vjeç, ndërsa ne Nëntor te vitit 2017 te gjitha rastet e diagnostikuara janë ne grupmoshën mbi 45 vjeç.






Figura12. Raste te diagnostikuar me HIV, Nëntor 2016 dhe Nëntor 2017

Hartoi: **Departamenti i Kontrollit të Sëmundjeve Infektive, Sektori i Epidemiologjisë, Programi Kombëtar i Tuberkulozit**

Silvia Bino, Eugena Tomini, Artan Simaku, Adela Vasili, Luljeta Alla, Elona Kureta, Rovena Daja, Marjeta Dervishi, Donika Bardhi.

Editoi: Rovena Daja

INSTITUTI I  
SHENDETIT  
PUBLIK

DEKSI